



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË

DREJTORIA E
PROJEKTEVE STRATEGJIKE,
EVROPËS, MIGRACIONIT, DIASPORES,
KOMUNIKIMIT DHE TRANSPARENCËS

Nr. 13262/2 Prot.

Lezhë, më 18/08 /2022

V E N D I M

Nr. 405 Datë 18/08 /2022

**“PËR MIRATIMIN E PAKETËS SË PLOTË NË KUADËR TË THIRRJES
SË KATËRT PUBLIKE PËR PROJEKT PROPOZIME NË PROGRAMIN
RAJONAL PËR DEMOKRACINË VENDORE NË BALLKANIN
PERËNDIMOR 2 (ReLOaD2)”**

Mbështetur në Ligjin Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” Neni 9 “Të drejtat dhe përgjegjësitë” pika 1.1 shkronja (b), Vendimi Nr.393 Date 18.07.2022 “ Per miratimin e Rregullores mbi Organizimin, Funksonimin, Detyrat dhe Kompetencat e Administrates se Bashkise Lezhe ", VKB Nr. 211 datë 31/10/2017 “Për miratimin e Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmejt Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP) dhe Bashkisë Lezhë si dhe miratimin e metodologjisë për alokimin e fondeve për organizatat e shoqërisë civile” pika 2. “Të miratohet Metodologjia LOD për alokimin e fondeve për organizatat e shoqërisë civile, të propozuar nga UNDP dhe të miratuar nga Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë”; “Memorandumi i Mirëkuptimit Ndërmjet Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara dhe Bashkisë Lezhë” Nr. Prot 17007 datë 22.09.2021; Ligjin Nr. 79 “ Për Sportin”, ndryshuar me ligjin Nr 105/2020, Neni 20 dhe 21; Planin Strategjik për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Komunitetit të Lezhës 2013-2030, Qellimi : Cilesia e jetes dhe komuniteti jane aktivitetet Nr : 121, 122, 123, 125; si dhe Prioritetit Nr 57, datë 13/06/2022 për “Financimin e Shoqatave Sportive të Federuara me Objekt Futbollin” për të përfaqësuar Lezhën ne kompeticione kombëtare dhe ndërkombëtare dhe për të nxitur të rinjtë e talentuar në futboll në Bashkinë Lezhë, si dhe VKB Nr 58 datë 13/06/2022 “Për një ndryshim në VKB Nr.177, datë 23/12/2021 “ Për miratimin e Buxhetit për vitin 2022 dhe PBA-së 2022-2024”; VKB Nr 78 datë 2 8/06/2022 “Përdorimin e Metodologjisë LOD Për Alokimin e Fondeve për Organizatat e Shoqërisë Civile për Fondin e Miratuar me VKB Nr 58, Datë 13/06/2022, si dhe VKB Nr.177, Datë 23/12/2021 “ Për Miratimin E Buxhetit Për Vitin 2022 si dhe PBA-Së 2022-2024”; Urdhërit Nr 366 datë 20/06/2022 “Për Krijimin e Grupit të Punës për kryerjen e



Procedurave për Hapjen e Thirrjes së 4-rt të Programit Reload të Financuar nga Bashkia Lezhë”; si dhe procesverbalin me Nr 13262/ 1 Prot date 01/08/2022.

V E N D O S A :

1. Miratimin e prioriteteve në kuadër të Thirrjes së Katërt publike për Projekt propozime në Programin Rajonal për Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor (ReLOaD2).
2. Miratimin e paketës së plotë në kuadër të Thirrjes së Katërt publike për Projekt propozime në Programin Rajonal për Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor (ReLOaD2).
Paketa e Thirrjes së Katërt ReLOaD2 përmban dokumentat si vijon :
 - Shtojca 6** Udhezuesi
 - Shtojca 7** Projekt Propozimi
 - Shtojca 8** Buxheti
 - Shtojca 9** Korniza Logjike
 - Shtojca 10** Plani i Aktiviteteve dhe dukshmërisë
 - Shtojca 11** Formulari i identifikimit administrativ dhe financiar
 - Shtojca 12** Deklarata për plotësimin e kritereve
 - Shtojca A** Deklarata e partneritetit
 - Shtojca B** Deklarata për shmangien e konfliktit të interesit
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Pjerin NDREU

